

Terma reference-punonjes social

Informacion

Qendra e Shërbimeve dhe praktikave Ligjore të Integruara është një organizatë lokale, që operon që prej vitit 2004 në fushën e të drejtave të njeriut, me një fokus të veçantë në grupet vulnerabël e sidomos tek fëmijët dhe të rinjtë duke ofruar shërbime ligjore e psiko-sociale, si dhe trajnime dhe hartim udhezuesish për profesioniste në fushën e ligjit dhe shërbimet sociale.

Qëllimi i shërbimit

Aktualisht, QSHPLI po kërkon të kontraktojë një punonjës social nga qarku Lezhë.

Detyrat dhe përgjegjësitë e punonjësit social

Punonjësi social duhet të ketë një njohje të mirë të kontekstit lokal, rrjetit të organizatave dhe komunitetit. E preferueshme është që ai të ketë eksperiencë në punën me grupet vulnerabël dhe kryesisht të rinjtë. Ai do të jetë përgjegjës për identifikimin e të rinjve, takimeve në grup të cilat do t'i organizojë në bashkëpunim me koordinatorin, duke i trajnuar te rinjte në fusha si aftësitë jetësore, punësueshmëria etj. Ai do të udhëzojë të rinjtë në shërbime të ndryshme që ofrohen nga projekti dhe jo vetëm. Për më tepër, ai është përgjegjës për sigurimin e pjesëmarrjes së të rinjve në aktivitetet e projektit dhe do të asistojë te rinjtë në çdo aktivitet te projektit ku ata marrin pjesë. Ai do të ndihmojë koordinatorin në kontaktimin e përfaqësuesve të pushtetit lokal, në kontaktimin e partnerëve dhe detaje të organizimit të aktiviteteve që lidhen me logjistikën. Ai do të marrë pjesë në trajnimet që donatori do të zhvillojë për stafin e projektit.

Kualifikimet e kërkuara:

- Të ketë përfunduar Fakultetin e Shkencave Sociale;
- Të ketë aftësi të mira në dokumentim dosjesh
- Të ketë njohuri të mirë të gjuhës angleze;
- Të ketë njohuri të mira në kompjuter, në paketën office;
- Të jetë i komunikueshëm dhe të krijojë mardhënie të mira pune në grup dhe Të ketë aftësi për të punuar me mbikqyrje minimale dhe nën presionin e kohës;
- Të ketë aftësi të mira në menaxhim kohe dhe planifikim;

Avantazh do të kenë kandidatët që kanë punuar më parë me NGO si dhe që kanë eksperiencë pune me të rinjtë.

Lokacioni i punës:

Lokacioni kryesor do të jetë në Lezhë, por punonjësi social mund të duhet të udhetojë shpesh në rrethina e fshatit. Gjithashtu, ai do të duhet të raste të ndryshme të udhetojë drejt Tiranës për pjesëmarrje në takime me stafin e qendrës, si dhe në trajnime të ndryshme që stafi organizon.

Termat kohorë të caktimit të ekspertit:

10 maj 2025-31 dhjetor 2025.

Politikat e QSHPLI

Si kusht për të hyrë në këtë program, punonjësi social duhet të nënshkruajë rregulloren e QSHPLI, si dhe Politiken e Sigurisë së Femijëve.

Dorezimi i aplikimit:

Kandidatët e interesuar duhet të paraqesin një letër interesi, një CV dhe një ofertë financiare në adresën office@qshpli.org ose dorazi pranë zyrave tona ose dorazi në adresën e zyrës (Lagjia Besëlidhja Bulevardi Gjergj Fishta Ndërtesa 5 katësh, Lezhë deri më 27.04.2025).